



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 850 Prot.

Tiranë, më datë 16.06.2023

VENDIM
Nr. 327, datë 16.06.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Sa”, Vendim Nr. 220, datë 07.04.2021 “Për Përcaktimin E Procedurave Për Hulumtimet Arkeologjike, Të Kushteve Të Posaçme Të Lëshimit Të Lejes, Dokumenteve Shoqëruese, Si Dhe Procedurave Për Shqyrtimin Ose Anulimin E Lejes Për Kryerjen E Hulumtimeve Arkeologjike” dhe “Rregullorja e arkeologut”, me Vendim Nr.2, datë 30.01.2009, të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 16.06.2023:

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit kërkimor-shkencor të ri “Kështjella e Beratit- dokumentimi grafik digjital dhe evolucioni historik”, me drejtues projekti Prof. Asoc. Dr. Eduard Shehi;
2. Para fillimit të projektit të bëhet njoftimi zyrtar pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
3. Pas përfundimit të projektit, një kopje e dokumentacionit si dhe lista e gjetjeve arkeologjike të depozitohen pranë IKTK-së dhe DRTK-së përkatëse;
4. Dokumentacioni i hartuar në kuadër të këtij projekti për vitin 2023 të dorëzohet pranë IKTK-së;
5. Të lidhet një marrëveshje ndërinstitucionale ndërmjet IKTK-së dhe Akademisë së Studimeve Albanologjike (ASA), bazuar në VKM-në nr. 338, datë 31.05.2023;
6. Ngarkohet IKTK dhe Akademia e studimeve Albanologjike për lidhjen e marrëveshjes, së cituar në pikën 5 të këtij vendimi;
7. Afati përfundimtar i punimeve është një vit nga miratimi në KKTKM;
8. Afati i përfunduar i punëve do të jetë sipas planit të punës të depozituar në IKTK;
9. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
10. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta QIRICI

